
**COMMAND AND CONTROL OF THE ENTERPRISE AND DEALING WITH
DISASTER PREVENTION MEASURES IN THE PROTECTION AND RESCUE
SYSTEM IN THE REPUBLIC OF THE NORTH MACEDONIA**

Muhamet Racaj

College Biznesi, Prishtina, Republic of Kosovo, muhametracaj61@gmail.com

Mende Solunchevski

International Slavian University, St. Nikola- Bitola, Republic of N. Macedonia, mendesolun@yahoo.com

Abstract: Natural and other disasters are constantly present in nature and society, causing great economic damage, but also are a direct threat to human health, flora and fauna. If they are so large that the community cannot face with its own forces and means they are disaster-stricken. Because of this, modern society undertakes numerous measures and activities for the protection and rescue of the population and the material goods of these danger sources, to not be manifested in the form of disasters.

Command enables effective and efficient performance of emergency work by making the right decisions, while control enables monitoring of tasks and resources in the work performance. Effective and efficient command and control is in function of disaster prevention and preparedness.

Keywords: Command, control, disasters

**KOMANDIMI DHE KONTROLLI NËMARRJEN DHE ZBATIMIN E MASAVE PËR
PARANDALIMIN E PASOJAVE TË KATASTROFAVE NË SISTEMIN PËR
MBROJTJE DHE SHPËTIM NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT**

Muhamet Racaj

College Biznesi, Prishtina, Republic of Kosovo, muhametracaj61@gmail.com

Mende Solunchevski

International Slavian University, St. Nikola- Bitola, Republic of N. Macedonia, mendesolun@yahoo.com

Abstrakt: Fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në vazhdimësi janë të pranishme në natyrën dhe shoqërinë, duke shkaktuar dëme të mëdha ekonomike, por edhe paraqesin rrezik të drejtëpërdrejtë për shëndetin dhe jetën e njeriut, florën dhe faunën. Në qoftëse të njejtët janë në madhësi me të cilën komuniteti nuk mund të ballafaqohet me forcat dhe mjetet e veta përjetohen si katastrofa. Për shkak të kësaj, shoqëria bashkëkohore ndërmer masa dhe aktivitete të shumta për mbrojtje dhe shpëtim të popullsisë dhe të mirave materiale të këtyre burimeve të rrezikimit, të mos manifestohet në lloj të katastrofave.

Komandimi mundëson kryerjen efektive dhe efikase të punës në gjendje emergjente përmes marrjes së vendimeve të duhura, ndërsa kontrollimi mundëson mbikqyrjen e punëve dhe resurseve në kryerjen e punës. Komandimi dhe kontrollimi efektiv dhe efikas është në funksion të parandalimit dhe gatishmërisë nga katastrofat.

Fjalët kyçe: komandimi, kontrollimi, katastrofat

1. HYRJJE

Republika e Maqedonisë së Veriut ballafaqohet me sfida të shumta në sistemet e sigurisë për ballafaqimin me fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera (FNFT) të cilët mund të çojnë deri në katastrofa. Për shkak të kësaj ndërmer masa të shumta parandaluese për mbrojtje dhe shpëtim të qytetarëve të saj dhe pronës së tyre.

Sistemi për mbrojtje dhe shpëtim (SMSH) është një nga sistemet më të rëndësishme për ballafaqimin me FNFT-të të cilët mund të çojnë deri në katastrofa. Në atë participojnë të gjithë personat juridik dhe fizik. Subjektet përgjegjëse janë Drejtoria për mbrojtje dhe shpëtim (DMSH) në nivel nacional dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale (NJVQL) në nivel lokal.

Komandimi dhe kontrollimi janë një nga funksionet menaxheriale më të rëndësishme që duhet të praktikohen si duhet për mbrojtjen dhe shpëtimin e suksesshëm. Komandimi dhe kontrollimi efektiv dhe efikas çojnë drejt mbrojtjes dhe shpëtimit më të mirë të popullsisë dhe të mirave materiale nga FNFT-të.

Punimi ofron shqyrtim të shkurtër të komandimit dhe kontrollimit në SMSH-në të bazuar në hulumtimin shkencor në subjektet përgjegjëse DMSH dhe NJVQL.

2. MENAXHIMI DHE KOMANDIMI NË SISTEMIN PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM

Menaxhimi dhe komandimi kanë lidhje siameze në sistmet e sigurisë. Për menaxhimin shumë është e rëndësishme udhëheqja të njohë natyrën e punës të organizatës, gjegjësishtë sistemin dhe sjelljen e të punsurave të tyre gjatë punës, ndërsa komandimi kërkon marjen e vendimeve të sakta në kohën e duhur, mobilizimin e forcave në kohë, kryerjen efektive dhe efikase të detyrave, ndërmarjen e përgjegjësisë nga strukturat komanduese në forcat për mbrojtje dhe shpëtim, ndjekjen e zgjuar të situatës dhe sanimin e gjendjes pas përfundimit të fatkeqësisë natyrore ose fatkeqëve tjetër.¹²⁶

Subjektet në Sistemin për mbrojtje dhe shpëtim (SMSH) janë:

- Organet shtetërore.
- Organet e administratës shtetërore.
- Ndërmarjet publike.
- Shoqëritë tregtare.
- Institucionet dhe shërbimet publike.
- Organizatat jo-qeveritare dhe
- Qytetarët.¹²⁷

Institucionet përgjegjëse në SMSH-në janë:

- Drejtoria për mbrojtje dhe shpëtim (DMSH) në nivel nacional dhe rajonal dhe
- Njësitë e vetqeverisjes lokale (NJVQL) në nivel lokal.

Me DMSH udhëheq drejtori të cilin e emëron Qeveria e RMV-së, ndërsa komandon komandanti i Shtabit kryesor për mbrojtje dhe shpëtim. Me NJVQL-në udhëheq Kryetari i komunës i zgjedhur në zgjedhje të drejtëpërdrejta nga qytetarët, ndërsa komandon komandanti i shtabit komunal për mbrojtje dhe shpëtim. Shumë është e rëndësishme këto persona të posedojnë aftësi të udhëheqësit. Aftësitë e fituara të udhëheqësit përmes aktiviteteve të mëparshme të punës, trajnimit dhe zhvillimit do të kontribuojnë në prëqindje të madhe udhëheqësi-komandanti të pranohet nga të punësuarit si udhëheqës.

Maksimumi i këtij pranimi do të arihet nëse tre grupet e faktorëve:

- Autoriteti ligjor.
- Autoriteti i ekspertit dhe
- Karizma personale në mënyrë të barabartë gjenden në personalitetin udhëheqës.

Udhëheqësi – komandanti me karakteristika të tilla tregon kujdes maksimal për punën dhe të punësuarit, kreativitet, inspirim dhe rezultate.¹²⁸

Lloji i tillë i udhëheqësit – komandantit është i gatshëm ti zgjidhë problemet udhëheqëse që dalin nga pozicioni dhe të ndërmarë përgjegjësi në situata krize dhe emergjente të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

Këtë më së mirë do ta arijë nëse zhvillon aftësi dhe shkathtësi në mënyrë efikase dhe sekuenciale ti praktikojë taktikat vijuese të punës me të punësuarit:

- Inspirimin.
- Bindjen.
- Konsultimin.
- Pjesëmarjen reciproke dhe
- Urdhërimin.

Në asnjë rast udhëheqësi nuk duhet të bëjë:

- Manipulim.
- Nënçmim dhe
- Presion të madh ndaj të punsurave për kryerjen e punës.¹²⁹
- Komandanti i shtabit është përgjegjës për organizimin e përgjithshëm, aftësimin dhe veprimin për mbrojtje dhe shpëtim në zbatimin e aksioneve për mbrojtje dhe shpëtim.
- Sjell planet për mbrojtje dhe shpëtim,
- Propozon strukturë organizative-formacuese të forcave për mbrojtje dhe shpëtim në zonën përkatëse,
- Është përgjegjës për riaftësimin, për mbrojtje dhe shpëtim,

¹²⁶ Солунчевски, М., Цивилна заштита, (учебник во печат) МСУ, Свети Николе-Битола, 2019, стр.328.

¹²⁷ Закон за заштита и спасување, Службен весник на РМ (пречистентекст) број 93/2012,

¹²⁸ Шермархорн, Ц., Менаџмент 11е (Management 11 e) Европа 92 Кочани, 2013, стр. 317.

¹²⁹ Wall, S., & Wall, S., The New Strategists, Free press, New York, 1995, p.196.

- Miraton vlerësimin e rrezikimit të teritorit nga FNFT-të,
- Udhëheq me punën e shtabit dhe me aksionet për mbrojtje dhe shpëtim të popullsisë dhe të mirave materiale.
- Në udhëheqjen realizon bashkëpunim me subjektet tjera të cilët janë me interes të mbrojtjes dhe shpëtimit.

Në vendimarrjen përdorë këto metoda të vendimarrjes:

- Të plotë.
- Të shkurtër dhe
- Direkte.¹³⁰

Sa më shumë aftësi udhëheqëse të posedojnë udhëheqësit – komandantët në SMSH aq do të jetë më e suksesshme komandimi në SMSH-në si kusht për parandalimin nga katastrofat.

3. KONTROLLIMI NË SISTEMIN PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM

Kontrollimi është proces me ndihmën e të cilës menaxherët mbikqyrin dhe rregullojnë sa në mënyrë efektive dhe efikase organizata dhe anëtarët e saj i kryejnë aktivitetet e nevojshme për realizimin e qëllimeve të organizative. Sistemet e kontrollimit janë sisteme formale për rregullimin, mbikqyrjen, vlerësimin dhe lidhshmerinë kthyesë që i sigurojnë menaxherët me informacione a veprojnë strategjitë organizative dhe struktura në mënyrë efektive dhe efikase.¹³¹

Kontrollimi në mbrojtje dhe shpëtim rregullon dhe vertetonë se në qfarë niveli efektivë dhe efikas SMSH-ja i kryen funksionet dhe realizon qëllimet e vendosura. Që të arihet kjo në SMSH-në kontrollimi kryhet në të gjitha fushat.

Fushat dhe resurset më të rëndësishme që kontrollohen janë:

- Rsurset njerëzore.
- Resurset materiale.
- Resurset fizike.
- Resurset e informacionit.
- Resurset financiare etj.

Për zbatimin e suksesshëm të kontrollimit në fushat e theksuara së pari vendosen standarde të kontrollimit. Të gjitha zgjidhjet e planifikuara që kanë të bëjnë me masat për mbrojtje dhe shpëtim dhe të forcave për mbrojtje dhe shpëtim paraqesin standarde për kontrollimin.

Standardet për kontrollimin në SMSH-në mund ti ndajmë në:

- Standarde që kanë të bëjnë me strukturën organizative të subjekteve në Sistemin për mbrojtje dhe shpëtim.
- Standarde që kanë të bëjnë me forcat për mbrojtje dhe shpëtim.
- Standarde që kanë të bëjnë me masat për mbrojtje dhe shpëtim.
- Mjetet financiare si standarde.
- Mjete personale për mbrojtje të qytetarëve si standarde dhe
- Standarde tjera.¹³²

Standardet e lartpërmendura janë rregulluar me akte të shumta normative: dekrete, udhëzime, doracak etj. Për parandalimin e suksesshëm nga katastrofat e nevojshme është të respektohen dhe zbatohen standardet e theksuara.

4. REZULTATET NGA HULUMTIMI NË SISTEMIN PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Janë bërë hulumtime të gjëra për menaxhimin e Sistemit për mbrojtje dhe shpëtim. Në hulumtimin janë përfshirë të punësuar në Drejtorinë për mbrojtje dhe shpëtim (DMSH-në), Njësitë e vetqeverisjes lokale (NJVQL-në), njësitë territoriale kundër-zjarrit (NJTKZ) dhe forcat për mbrojtje dhe shpëtim. Disa prej atyre hulumtimeve i paraqesim për nevojat e këtij punimi.

¹³⁰Prirucnikzaobukastabova CZ, Grupaautora, ZUNS-Beograd, 1987, str. 46.

¹³¹Gareth R. Jones., Jennifer M. George., *СовременМенаџмент, (Modern Management)*, Skorje, 2010, 433.

¹³²Shif më gjersishtë: Солунчевски, М., *Соверемен менаџмент на системот за заштита и спасување, МНД, Битола, 2018, стр. 228-237.*

Tabela 1. Mënyra e menaxhimit të udhëheqësve-komandantëve

| PËRGJIGJE | Të punësuar në DMSH dhe NJVQL | | Të punësuar në NJTKZ | | Në total | |
|--------------------------------|-------------------------------|-------|----------------------|-------|----------|-------|
| | Numri | % | Numri | % | Numri | % |
| 1 | 2 | | 3 | | 4 | |
| | Numri | % | Numri | % | Numri | % |
| Gjithmonë vepron siduhet | 32 | 40,5 | 32 | 26,4 | 64 | 32,0 |
| Vepronëvarësitësituatës | 44 | 55,6 | 61 | 50,4 | 105 | 52,5 |
| Vepronpërpërfitim personal | 3 | 3,7 | 21 | 17,4 | 24 | 12,0 |
| Vepronpërpërfitimtëorganizatës | 0 | 0 | 7 | 5,8 | 7 | 3,5 |
| Në total | 79 | 100,0 | 121 | 100,0 | 200 | 100,0 |

Sipas të dhënave të fituara nga analiza e bërë për këtë Pyetje, ekziston dallim i rëndësishëm statistikor mes qëndrimeve dhe mendimeve të pritura dhe të vëzhguara të të anketuarve.

Në menaxhimin në SMSH-në dominojnë udhëheqës të situatës të cilët udhëheqin në varësi të situatës. Kjo do të thotë ato ndonjëherë përdorin më shumë stil autoritar, ndërsa ndonjëherë më shumë stil demokratik të udhëheqjes. Nga ekzekutuesit 32% janë perceptuar se gjithmonë veprojnë si duhet, ndërsa 12% veprojnë ekskluzivisht për përfitim personal dhe 3.5% për përfitim të organizatës. Dhe sipas kategorive nuk ka devijimi edhe tek të punësuarit në DMSH-në, NJVQL-në dhe NJTKZ-në dominon qasja e situatës. Ka hapësirë të përmisohet qasja e drejtë dhe qasja e situatës në krahasim të qasjeve tjera që janë më të afërta deri në stilin autokratik të udhëheqjes.

Tabela 2 Shqyrtimi i karakteristikave të udhëheqësve-komandantëve

| Përgjigje | Tëpunësuar në DMB dhe NJVQL | | Tëpunësuar në NJTKZ | | Forcatpër MSH | | Në total | |
|--------------|-----------------------------|-------|---------------------|-------|---------------|-------|----------|-------|
| | Numri | % | Numri | % | Numri | % | Numri | % |
| 1 | 2 | | 3 | | 4 | | 5 | |
| | Numri | % | Numri | % | Numri | % | Numri | % |
| Njohuri | 46 | 58,2 | 77 | 63,6 | 155 | 64,6 | 278 | 63,2 |
| Ndershmëri | 11 | 13,9 | 11 | 9,1 | 26 | 10,8 | 48 | 10,9 |
| Sinqeritet | 9 | 11,4 | 5 | 4,1 | 7 | 2,9 | 21 | 4,8 |
| Frymëekipore | 5 | 6,4 | 13 | 10,7 | 8 | 3,3 | 26 | 5,9 |
| Guxim | 0 | 0 | 1 | 0,8 | 5 | 2,1 | 6 | 1,3 |
| Vizion | 8 | 10,1 | 14 | 11,7 | 39 | 16,3 | 61 | 13,9 |
| Në total | 79 | 100,0 | 121 | 100,0 | 240 | 100,0 | 440 | 100,0 |

Sipas të dhënave të fituara nga analiza e bërë për këtë pyetje, ekziston dallim i rëndësishëm statistikor mes qëndrimeve dhe mendimeve të pritura dhe të vëzhguara të të anketuarve.

Të anketuarit mendojnë se nga karakteristikat individuale, eprorët e tyre duhet më shumë të posedojnë: njohuri me 63.2%, vizion me 13.9% dhe ndershmëri me 10.9%. Karakteristikat tjera siç janë: fryma ekipore, sinqeriteti dhe guximi janë minimale me përqindje të përbashkët prej 12%. Analizimi sipas kategorive të të anketuarve ka larmi të caktuar. Tek të punësuarit në DMSH-në dhe NJVQL-në radhitja është: njohuri 58.2%, ndershmëri 13.9% dhe sinqeritet 11.4%, tek të punësuarit në NJTKZ-në radhitja është: njohuri 63.6%, vizion 11.7% dhe frymë ekipore 10.7%, ndërsa tek pjestarët e forcave për MSH janë: njohuri 6.6%, vizion 16.3% dhe ndershmëri 10.9%.

Tabela 3 Shqyrtimi i mjeteve për kontrollimin në SMSH

| Përgjigje | Tëpunësuar në DMSH dhe NJVQL | | Tëpunësuar në NJTKZ | | Në total | |
|----------------------------------|------------------------------|------|---------------------|------|----------|------|
| | Numri | % | Numri | % | Numri | % |
| 1 | 2 | | 3 | | 4 | |
| | Numri | % | Numri | % | Numri | % |
| Kontrollifinanciar | 6 | 7,6 | 7 | 5,8 | 13 | 6,5 |
| Kontrolliimenaxhimittëprojekteve | 4 | 5,1 | 6 | 4,9 | 10 | 5,0 |
| Sistemiikontrollittëtëpunësuarve | 33 | 41,7 | 72 | 59,6 | 105 | 52,5 |

| | | | | | | |
|---|----|-------|-----|-------|-----|-------|
| Kontrolli i rezultateve të planifikuara dhe të arritura | 24 | 30,4 | 36 | 29,7 | 60 | 30,0 |
| Nuk janë përgjigjur | 12 | 15,2 | 0 | 0 | 12 | 6,0 |
| Në total | 79 | 100,0 | 121 | 100,0 | 200 | 100,0 |

Sipas të dhënave të fituara nga analiza e bërë për këtë pyetje, ekziston dallim i rëndësishëm statistikor mes qëndrimeve dhe mendimeve të pritura dhe të vëzhguara të të anketuarve.

Kontrollimi është funksion shumë i rëndësishëm i menaxhmentit e cila në SMSH-në e ndjek realizimin e planeve dhe rrjedhën e aksioneve. Në SMSH-në dominojnë: sistemi i kontrollit të të punësuarve me 52.5% dhe kontrolli i rezultateve të planifikuara dhe të arritura 30%. Radhitja është e njejtë edhe sipas kategorive tek të punësuarit në DMSH-në, NJVQL-në dhe NJTKZ-në. Në të ardhmen duhet të ritet menaxhmenti i kontrollit të projekteve.

Tabela 4 Shqyrtimi i resurseve që mungojnë në SMSH

| Përgjigje | Tëpunësuar në DMSH dhe NJVQL | | Tëpunësuar në NJTKZ | | Forcat për MSH | | Në total | |
|------------------------|------------------------------|-------|---------------------|-------|----------------|-------|----------|-------|
| | Numri | % | Numri | % | Numri | % | Numri | % |
| Punëtorë kompetent | 26 | 32,9 | 67 | 55,3 | 56 | 23,3 | 149 | 33,8 |
| Pajisje dhe PMT | 47 | 59,6 | 37 | 30,7 | 135 | 56,2 | 219 | 49,7 |
| Objekte | 0 | 0 | 11 | 9,1 | 2 | 0,8 | 13 | 2,9 |
| Automjet motorike | 2 | 2,5 | 6 | 4,9 | 11 | 4,6 | 19 | 4,3 |
| Teknologji informatike | 2 | 2,5 | 0 | 0 | 6 | 2,5 | 8 | 1,8 |
| Nuk janë përgjigjur | 2 | 2,5 | 0 | 0 | 30 | 12,6 | 32 | 7,5 |
| Në total | 79 | 100,0 | 121 | 100,0 | 240 | 100,0 | 440 | 100,0 |

Sipas të dhënave të fituara nga analiza e bërë për këtë pyetje, ekziston dallim i rëndësishëm statistikor mes qëndrimeve dhe mendimeve të pritura dhe të vëzhguara të të anketuarve.

Për kryerjen e suksesshme të punës dhe funksionimin e SMSH-në të nevojshme janë resurse adekuate sipas cilësisë dhe sasisë. Të anketuarit mendojnë se përqindja e madhe prej resurseve që janë parashikuar në aktet normative mungojnë. Përqindja më e madhe prej resurseve sipas cilësisë dhe sasisë që mungojnë për funksionimin e suksesshëm të SMSH-së janë: pajisje dhe pajisje motorike teknike (PMT-të) 49.7% dhe punëtorët kompetent 33.8%. Nga resurset tjera siç janë: mungesat në objektet, automjetet dhe teknologjisë informatike (TI-të) janë minimale dhe ato janë 2.9%, 4.3% dhe 1.8%. Ka dallim të caktuar nëse analizohen mungesat në resurset sipas kategorive të të anketuarve. Tek të punësuarit në DMSH dhe NJVQL dhe pjestarëve të forcave për mbrojtje dhe shpëtim mungesat vërehen tek: pajisjet dhe PMT dhe punëtorët kompetent, ndërsa tek të punësuarit në NJTKZ kjo radhitje është anasjelltas. Zjarëfikësit mendojnë se së pari mungojnë punëtorë kompetent, ndërsa pastaj pajisja dhe PMT-të.

5. PËRFUNDIM

Në menaxhimin dhe kontrollin në sistemin e mbrojtjes dhe shpëtimit (SMSH-në) dominojnë udhëheqësit komandantët e situatave të cilët udhëheqin në varësi të situatës. Qasja e situatës të udhëheqjes dominon në menaxhimin në DMSH-në, NJVQL-në dhe NJTKZ-në. Kjo do të thotë ato reciprokisht përdorin stil autoritar dhe stil demokratik të udhëheqjes në varësi të situatës.

Udhëheqësit janë drejtuesit më të mirë. Shumica e pjestarëve të SMSH-së eprorët e tyre i përjetojnë si udhëheqës të vërtetë. Udhëheqësia është shprehur në udhëheqjen në DMSH-në dhe NJVQL-në në krahasim të forcave për mbrojtje dhe shpëtim dhe NJTKZ-së. Karakteristikat më të rëndësishme të cilët duhet ti kenë udhëheqësit me tendencën e udhëheqësit janë: njohuria, vizioni dhe ndershmëria.

Hulumtimi tregon se përqindja më e madhe nga resurset që janë parashikuar në aktet normative mungojnë. Përqindja më e madhe e resurseve sipas cilësisë dhe sasisë që mungojnë për funksionimin e suksesshëm të SMSH-së janë: pajisja dhe PMT-të dhe punëtorët kompetentë.

Ka nevojë për përmisimin e standardeve të kontrollit. Të nevojshme janë përmisime dhe intensifikimin e kontrolleve të subjekteve në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit, me theks të parandalimit, por edhe imponohet nevoja nga shqiptimi i dënimeve adekuate për shkak të eliminimit të mungesave tek subjektet, me qëllim sigurimin e mbrojtjes dhe shpëtimit më të mirë të popullsisë. Në kuadër të SMSH-së tek subjektet përgjegjëse e nevojshme është eliminimi i mungesave të detektuara në aspekt të resurseve cilësore dhe sasiore, përkatësishtë sigurimin e tyre përkatës.

LITERATURA

- Gareth R. J., George J.M., (2010) *Современ Менаџмент, (Modern Management)*, Skopje
- Grupa autora (1987) Prirucnik za obuka stabova CZ, ZUNS-Beograd
- Racaj, M., (2017) Menaxhimipolicor, (ligjiratëautorizuara) Univerziteti Tetovës-Tetovë
- Racaj, M., (2015) Defining the crisis and crisis management. In: Proceedings of the international scientific conference “Crisis management: challenges and prospective”, Skopje, Macedonia.
- Wall, S., & Wall, S., (1995) *The New Strategists*, Free press, New York
- Закон за заштита и спасување, Службенвесник на РМ (пречистентекст) број 93/2012,
- Солунчевски, М., (2019) Цивилна заштита, (учебниок во печат) МСУ, Свети Николе-Битола
- Солунчевски, М., (2018) Совермен менаџмент на системот за заштита и спасување, МНД, Битола
- Шермархорн, Ц., (2013) Менаџмент 11е (Management 11 e) Европа 92 Кочани